



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 02.05.2023

Nr: 73

Ora: 14:30

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS NR. 17, DATË 26.04.2023 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË
ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 02.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKT: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj z. Sotiraq Filo, kryetar i bashkisë Korçë dhe ndaj zj. Mariana Jorgji, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Korçë.



BAZË LIGJORE:

Neni 19, pika 1, shkronja "c" dhe neni 21, pika 1, shkronja "dh" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. Pranë Komisionit Qendror të zgjedhjeve është regjistruar denoncimi **nr. 284 ID** dhe denoncimi **nr. 285 ID**, ku pretendohet se më datë 01.04.2023, bashkia Korçë ka zhvilluar veprimtarinë publike me objekt "Takim prezantues me asamblenë e zgjeruar", raportuar në KQZ në datën 31.03.2023.
2. Me vendimin nr. 231, datë 31.03.2023 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur ndalimin e zhvillimit të kësaj veprimtarie, por pavarësisht ndalimit, ky aktivitet sërish është zhvilluar. Denoncuesit pretendojnë se zhvillimi i këtij aktiviteti të ndaluar përbën shkelje të nenit 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", si dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator "Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve".
3. Nisur nga denoncimet e mësipërme, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vënë në lëvizje KAS-in, me anë të një kërkesë, duke kërkuar marrjen e masës administrative me gjobë në vlerë 10 000 (dhjetë mijë) lekë për kryetarin e bashkisë Korçë si dhe gjobë në vlerën 5 000 (pesë mijë) lekë për personin përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Korçë.
4. KAS-i caktoi me short z. Ledio Braho relator për shqyrtimin e kërkesës nr. 17, datë 26.04.2023 të Komisionerit dhe në seancën paraprake vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesës, duke e caktuar seancën e shqyrtimit më 02.05.2023, ora 14:30.

5. Seanca e datës 02.05.2023 u zhvillua me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, si përfaqësues i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të specialistëve të administratës së KQZ-së. Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Korçë, si dhe Kryetari i Bashkisë, të njoftuar rregullisht, nuk u paraqitën në seancën e shqyrtimit.

6. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesën nr. 17, datë 26.04.2023 të Komisionerit;
- Vendimin e Komisionerit nr. 412, datë 25.04.2023 “Për shqyrtimin administrativ ndaj kryetarit të bashkisë Korçë dhe personit përgjegjës në bashkinë Korçë”;
- Vendim e Komisionerit nr. 231, datë 31.3.2023 “Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive me karakter publik të Bashkisë Korçë”.
- Denoncimet nr. 284 ID dhe nr. 285 ID për bashkinë Korçë;
- Raportin e monitorimit, datë 03.04.2023, e regjistruar me nr. 246 ID
- Emaillet e dërguara me lëndë “Kërkesë për informacion” nga adresa e KQZ-së drejt personit përgjegjës të bashkisë Korçë.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstaton:

1. Shkelja e konstatuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, për të cilën kërkon sanksion administrativ ka në fokus zhvillimin e një veprimtarie publike, e cila është zhvilluar pavarësisht nga vendimi i ndalimit të zhvillimit të saj.
2. Nga provat e administruara në hetimin administrativ të kryer nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, rezulton se aktiviteti i zhvilluar është qartazi aktivitet politik, Asamble e Zgjeruar e Partisë Socialiste. Ky aktivitet është organizuar nga një parti politike dhe kryetari i bashkisë ka qenë i ftuar në të.
3. Nuk mundet kurrsesi që një institucion si bashkia Korçë të organizojë Asamble të Zgjeruar të një partie politike. Nga ky fakt, kuptohet qartë se kryetari i bashkisë ka marrë pjesë si i ftuar

në këtë aktivitet, në cilësinë e kandidatit për kryetar bashkie të propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, në kuadër të fushatës elektorale të këtij subjekti zgjedhor.

4. Në nenin 92 pika 1 të Kodit Zgjedhor parashikohet se ***“Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”.***

Pra, detyrimi për raportim rëndon vetëm mbi institucionet publike të cilat organizojnë aktivitetet publike. Në rastin objekt shqyrtimi aktiviteti i zhvilluar nuk është aktivitet institucional, dhe si i tillë nuk ngarkon me detyrim për raportim bashkinë Korçë, pavarësisht pjesëmarrjes në të të kandidatit për kryetar bashkie që njëkohësisht është edhe kryetar bashkie në detyrë.

Referuar dhe pretendimeve të Bashkisë Korçë të administruara nga KQZ, raportimi i këtij aktiviteti nga ana e bashkisë Korçë ka qenë një gabim njerëzor.

5. Për sa i përket pretendimit të denoncuesve se aktiviteti është zhvilluar në ambiente publike që administrohen nga Bashkia Korçë, i referohemi nenit 91 të Kodit Zgjedhor që parashikon se ***“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.”***
6. Siç është shprehur dhe Komisioneri në kërkesën e tij nr. 17, datë 26.04.2023 drejtuar KAS, qendra sportive ku është zhvilluar aktiviteti elektorale është “shoqëri aksionare”. Referuar

legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, këto të fundit e ushtrojnë aktivitetin në përputhje me statutin e tyre dhe legjislacionin në fuqi. KAS ju vendos në dispozicion dhe një faturë tatimore që ishte lëshuar. Nga ekstremitetet e kësaj fature tatimore rezulton se ajo është lëshuar në datën 01.04.2023 (datën e zhvillimit të aktivitetit), shitës është subjekti tregtar “Qendra Sportive Korçë” sh.a. me NIPT L84513003Q dhe blerës është personi fizik Vangjush Nico. Po ashtu, referuar Ekstraktit Historik të Regjistrimit Tregtar të kësaj shoqërie, rezulton se objekti i aktivitetit të saj është *“Projektimi, financimi, zhvillimi dhe menaxhimi i projekteve të sporteve të të gjitha llojeve me qëllim nxitjen dhe masivizimin e sportit, krijimi i akademive sportive dhe ekipeve zinxhir, dhënia në përdorim të tretëve, ruajtja, mirëmbajtja dhe menaxhimi i objekteve që shoqëria ka në administrim. Çdo aktivitet tjetër në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kryerja e pagesave të dietave”*.

7. Sipas objektit të aktivitetit të sipërcituar, ambientet e Qendrës Sportive Korçë, mund t’i jepen në përdorim të tretëve për çdo lloj aktiviteti. Në këto kushte, për aq kohë sa nuk ka favorizim për dhënien në përdorim të këtyre ambienteve për subjektin zgjedhor, por ai është dhënë në kuadër të aktivitetit tregtar të shoqërisë, atëherë përdorimi i këtyre ambienteve nga Partia Socialiste konsiderohet i përligjur. Duke qenë se aksionar i vetëm i kësaj shoqërie është Bashkia Korçë Do ishim në kushtet e shkeljes së nenit 91 të K.Zgjedhor, nëse ambientet e kësaj shoqërie do ishin vënë në përdorim të Partisë Socialiste pa kundërshtim, veprim ky që do të binte ndesh edhe me nenin 21 paragrafi i parë të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike” i ndryshuar, që parashikon se *“Ndalohet ndihma financiare dhe materiale nga qeveri dhe nga ente publike ose private të huaja, si dhe nga ente vendase publike ose me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror”*.
8. Në përfundim, bazuar në argumentet e mësipërme, KAS gjykon se aktiviteti i zhvilluar është aktivitet politik i organizuar nga Partia Socialiste, dhe si i tillë, ndalimi i këtij aktiviteti nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, si dhe kërkesa e tij për vendosjen e sanksioneve administrative konsiderohen si të pambështetura në ligj dhe në prova.

PËR KËTO ARSYE:

Për të gjitha arsyet e shtjelluara më sipër dhe mbështetur në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 45, të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës së Komisionerit nr. 17, datë 26.04.2023 për vendosjen e sanksioneve administrative.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar